

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin””
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Faza e konsultimit
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	-
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	24 Janar 2020 -13 Shkurt 2020
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	20.01.2020
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	-
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2020 – MASR- Nr. 2
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Denisa Veliu, denisa.veliu@arsimi.gov.al Nr. tel: 0696128782 Ardjana Gjini, ardjana.gjini@arsimi.gov.al Nr. tel: 0693622989 Florian Nurçe, florian.nurce@arsimi.gov.al Nr. tel: 0682074495 Gertian Bajraktari gertian.bajraktari@arsimi.gov.al Nr. tel: 0695438958
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i>	
<p>Problemi që merret në shqyrtim lidhet me fenomenin shqetësues të dhunës në mjediset sportive, me të cilin ndeshen shoqëritë sportive dhe qytetarët e këtij vendi. Nga sa rezulton, dhuna e shfaqur në mjediset sportive, ka dëmtuar rëndë sportin, duke sjellë si rrjedhojë uljen e rendimentit të sportistëve. Fenomeni i dhunës i shfaqur në mjediset sportive, ka dëmtuar rëndë, edhe spektatorët, të cilët në disa raste janë përballur me dhunën.</p> <p>Ndërhyrja e qeverisë është e rëndësishme pasi mosmarrja e masave deri më tani për situatën e sipërcituar ka sjellë si pasojë vështirësi në procesin e monitorimit dhe parandalimit të</p>	

dhunës, të shfaqur gjatë aktiviteteve sportive, si dhe vështirësi lidhur me identifikimin e autorëve të veprave penale.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

- parandalimi i dhunës në aktivitetet sportive;
- mbrojtja e të drejtave të tifozëve dhe organizatave sportive;
- krijimi i kushteve të nevojshme për përjashtimin e materialeve mjekësore, nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar;

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të disavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0 (status quo): Të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues e konkretisht me ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”. Pra ruajtja “status quo”-së (duke mosndërhur me amendime të mëtejshme, në ligjin ekzistues dhe duke mos hartuar një projektligji të ri).

Opsioni 1: Miratimi i një ligji të ri si bazë ligjore për përmirësimin e situatës aktuale lidhur me sportin në vend.

Opsioni 2 (i preferuar): Ndryshimi i ligjit ekzistues.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike të opsionit të preferuar do të jenë pozitive e të drejtpërdrejta për Agjencinë e Shërbimit të Sportit (Mjekësia Sportive), e cila nuk do të paguajë detyrimet doganore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar për listën e materialeve të pajisjeve sportive dhe pajisjeve mjekësore në funksion të sportit.

Nga ana tjetër, ky opsion të do të sjellë kosto të drejtpërdrejta për Buxhetin e Shtetit, pasi nuk do të vjelë të ardhura as nga pagesa e detyrimeve doganore të Agjencisë së Shërbimit të Sportit.

Ndikimet sociale do të përfshijnë përmirësimin e marrëdhënies tifozë-organizata sportive, në sajë të sanksionimit të rregullave përmes *kartës së tifozit*. Sporti sipas legjislacionit shqiptar konsiderohet si një e drejtë e aksesueshme për të gjithë. Me anë të këtij projektligji synohet të përmirësohet marrëdhënia midis tifozëve, organizatave dhe klubeve sportive,

marrëdhënie e cila duhet të trajtohet dhe të perceptohet nga palët si një marrëdhënie ortakërie me karakter parandalues për trazirat në sport. Konkretisht, karta e tifozit mund të zgjidhë çështje lidhur me anëtarësimin, këshillimin dhe informacionin, aksesin dhe përdorimin e stadioneve, sigurinë e spektatorëve/sportdashësve/tifozëve, mënyrën e shitjes së biletave, aktivitete që i drejtohen komunitetit si dhe çmime për tifozët besnikë dhe luftën kundër racizmit dhe dhunës.

Në organizatat sportive ndikimet që ky ligj do të ketë do të jenë ndikime të drejtpërdrejta, ku përmendim krijimin dhe lëshimin e kartës së tifozit nga organizatat sportive, pas anëtarësimit të tifozit, sipas llojit të veprimtarisë sportive që kjo organizatë ushtron, përjashtimi nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar për Agjencinë e Shërbimit të Sportit (Mjekësia Sportive), etj. Frekuenca e ndikimeve pozitive në gjendjen aktuale do të jetë e vazhdueshme.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është **Opsioni 2**, pra ndryshimi i ligjit ekzistues. Opsioni i preferuar do të sigurojë bazën ligjore për një model të ri të përmirësimit të statusit të tifozit nëpërmjet parashikimit të një dokumenti ligjor si karta e tifozit e cila do të zgjidhë çështje lidhur me anëtarësimin, këshillimin dhe informacionin, aksesin dhe përdorimin e stadioneve, sigurinë e spektatorëve/sportdashësve/tifozëve, mënyrën e shitjes së biletave, aktiviteteve që i drejtohen komunitetit si dhe çmime për tifozët besnikë dhe luftën kundër racizmit dhe dhunës.

Gjithashtu, ndryshimi i ligjit të sportit është parë i nevojshëm në kuadër të përfshirjes së materialeve mjekësore në listën e materialeve që përjashtohen nga detyrimet doganore.

Gjithashtu, është dhënë edhe kostoja për buxhetin e shtetit (shih tabelën më poshtë).

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë), në 000 lekë.

Financimi	Viti 1_ 2020	Viti 2_ 2021	Viti 3_ 2022
Total			
Buxheti i shtetit			
Të pambuluara			

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Projektligji është hartuar nga grupi i ndërinstytucional i punës i ngritur me Urdhrin nr. 57, datë 25.3.2019, të Kryeministrit, “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit Ndërinstytucional për Reformën në Sport”. Projektligji është konsultuar me palët e interesuara në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe në faqen e konsultimit publik www.konsultimipublik.gov.al dhe nuk ka pasur komente/sugjerime nga qytetarët apo grupet e interesit.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi i politikës që propozohet do të realizohet nga ministria përgjegjëse për sportin, struktura të tjera sportive si organizatat sportive, etj., si dhe tifozët.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe organizatat sportive do të monitorojnë situatën e sportit në vend, si dhe respektimin e rregullave dhe konform përcaktimeve të marrëveshjes midis tifozëve dhe organizatave përkatëse sportive, të ashtuquajtur “*karta e tifozit.*”.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, ndër të tjera synon zhvillimin e sportit. Legjislacioni është i ndërtuar në mënyrë të tillë që sporti të jetë një e drejtë e aksesueshme për të gjithë. Dimensionin social i sportit është i përfshirë dhe në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”, duke i dhënë sportit karakter gjithëpërfshirës dhe promovues. Sporti në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari publike dhe si e tillë ka interesin maksimal për nxitje dhe promovimin e tij, për përmirësimin e shëndetit dhe jetës së gjithkujt. Kohët e fundit, Shqipëria, po përballlet me një fenomen shqetësues, e cila është dhuna në mjediset sportive, e cila përbën një nga problematikat e shumta që ndeshet shoqëria shqiptare. Subjektet të cilat përballen, me dhunën në ambientet sportive, janë shoqëritë sportive dhe qytetarët e këtij vendi. Nga sa rezulton, dhuna e shfaqur në mjediset sportive, ka dëmtuar rëndë sportin, si një element i rëndësishëm kulturor, pasi në rezultatet e sportit, ka ndikuar fakti, se nëse një lojtar sportiv i është ushtruar dhunë psikologjike apo fizike para ose/dhe gjatë zhvillimit të ndeshjes, kjo gjë ka sjellë, si rrjedhojë uljen e rendimentit të lojtarit gjatë futbollit, si dhe njëkohësisht një rezultat të gabuar të ndeshjes. Fenomeni, i dhunës i shfaqur në mjediset sportive, ka dëmtuar rëndë, edhe spektatorët, të cilët në disa raste para/gjatë ose në përfundim të aktivitetit sportiv, janë përballur me dhunën. Kjo për shkak, se situata sa vjen e përkeqësohet, pasi grupime të caktuara të tifozëve të ekipeve të ndryshme reagojnë ashpër ndaj njëra tjetrës. Rasti i fundit i konstatuar, është Kampionati Kombëtar i Futbollit, ku pothuajse në të gjitha mjediset, ka pasur raste dhune. Por, dhuna, nuk është konstatuar vetëm në sport, por edhe në Kampionatin Kombëtar të Volejbollit dhe të Basketbollit.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave*

Hartimi i këtij ligji ka ardhur si pasojë e mungesës së një parashikimi ligjor që përcakton të drejtat dhe detyrimet e organizatës sportive ndaj tifozëve të saj si dhe anasjelltas. Ky projektligj synon përmirësimin e infrastrukturës sportive, duke qenë se sporti jep një kontribut të rëndësishëm në kohezionin ekonomik dhe shoqëror. Sporti adreson nevojat dhe gjendjen specifike të grupeve të nënpërfaqësuar duke marrë parasysh rolin e veçantë që mund të luajë për të rinjtë, njerëzit me aftësi të kufizuara dhe njerëzit me prejardhje më pak të privileguara. Sporti gjithashtu mund të lehtësojë integrimin në shoqëri, si dhe të mbështesë dialogun ndërkulturor. Sporti sipas legjislacionit shqiptar konsiderohet si një e drejtë e aksesueshme për të gjithë.

Një nga shkaqet e problemit dhe gjendjes aktuale të sportit në vendin tonë është dhuna në mjediset sportive. Grupet që preken nga ky problem janë organizatat sportive, sportistët dhe tifozët.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë*

Ndërmarrja e një reforme nga ana e Qeverisë për të përmirësuar ligjin nr.79/2017, “Për sportin” është e nevojshme për parandalimin e dhunës në aktivitetet sportive si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe detyrimeve të organizatave sportive ndaj tifozëve dhe anasjelltas.

- Në zbatim të urdhrit nr. 57, datë 25.3.2019, të Kryeministrit, “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit Ndërinstitucional për Reformën në Sport”, është ngritur grupi ndërinstitucional i punës me qëllim identifikimin e problematikave të kuadrit ligjor në fuqi. Në përfundim, është konkluduar nevoja e ndryshimit të kuadrit ligjor në fuqi, ku konkretisht është propozuar trajtimi i disa çështjeve, siç janë krijimi dhe lëshimi i kartës së tifozit, përjashtimi nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar për Agjencinë e Shërbimit të Sportit.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë*

Objektivat kryesore të politikës janë:

- parandalimi i dhunës në aktivitetet sportive;
- mbrojtja e të drejtave të tifozëve dhe organizatave sportive;

- krijimi i kushteve të nevojshme për përjashtimin e materialeve mjekësore, nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar;

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura*

Opsioni 0: – status quo-ja. Opsioni i status quo-së (0) shoqërohet me një vakum ligjor dhe institucional dhe si pasojë nuk adreson mbrojtjen e të drejtave të tifozeve/organizatave sportive në rastet e shfaqjes së dhunës përgjatë zhvillimit të aktiviteteve sportive.

Opsioni 1: Miratimi i një ligji të ri si bazë ligjore për përmirësimin e situatës aktuale lidhur me sportin në vend. Miratimi i një ligji të ri nuk është parë i arsyeshëm në këtë rast, duke qenë se ligji për sportin është një ligj i miratuar së fundmi. Problematikat e evidentuara në të janë respektivisht të vogla dhe është vlerësuar që përmirësimi i tyre mund të bëhet vetëm më ndryshimin/shtimin e pak neneve në ligjin aktual në fuqi.

Opsioni 2 (i preferuar): Ndryshimi i ligjit ekzistues. Ndryshimi i ligjit ekzistues është opsioni i preferuar në këtë rast, duke qenë se nëpërmjet projektligjit që kërkohet të miratohet, synohen të trajtohen vetëm tri çështje, siç është karta e tifozit, përjashtimi nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar për Agjencinë e Shërbimit të Sportit. Ky konkluzion është arritur edhe pas takimeve të shumta që grupi i punës, ngritur me urdhrin e kryeministrit, nr. 57 datë 25.03.2019, ka zhvilluar, me qëllim identifikimin e problematikave të kuadrit ligjor në fuqi. Në përfundim, është konkluduar nevoja e ndryshimit të kuadrit ligjor në fuqi, ku konkretisht është propozuar trajtimi i pikave të sipërcituara.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Ndër grupet kryesore që preken nga implementimi i këtij projektligji janë organizatat sportive, tifozët, Agjencia e Shërbimit të Sportit etj.

Ky ligj do të ketë ndikime të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta tek tifozët dhe organizatat sportive.

- Si ndikime të drejtpërdrejta që ky projektligj do të ketë tek organizatat sportive përmendim:
 - ✓ krijimi dhe lëshimi i kartës së tifozit;
 - ✓ përmirësimi i marrëdhënieve midis tyre dhe tifozëve, duke marrë masa për parandalimin e dhunës në sport;
- Si ndikime të drejtpërdrejta që ky projektligj do të ketë tek tifozët përmendim:
 - ✓ pajisja me kartën e tifozit si një marrëveshje e detyrueshme midis tifozëve dhe organizatës sportive/klubit. Karta e tifozit mund të zgjidhë çështje lidhur me anëtarësimin, këshillimin dhe informacionin, aksesin dhe përdorimin e stadiumeve, sigurinë e spektatorëve/sportdashësve/tifozëve, mënyrën e shitjes së biletave, aktivitete që i drejtohen komunitetit si dhe çmime për tifozët besnikë dhe luftën kundër racizmit dhe dhunës;
 - ✓ përmirësimi i marrëdhënieve midis tyre dhe organizatave sportive.
- Si ndikim jo të drejtpërdrejtë që ky projektligj do të ketë tek organizatat sportive dhe/apo tifozët përmendim ndryshimin e sjelljeve të tifozëve në kuadër të evitimit/uljes së sjelljeve të dhunshme përgjatë aktiviteteve sportive, si një nga problemet kyçe që haset sot në vend.
- Marrëdhëniet normale dhe strukturat e komunikimit ekzistues midis mbështetësve dhe organizatave të tifozët, sidomos e ekipeve kundërshtarë, por edhe në mesin e mbështetësve të të njëjtit klub, mundësojnë marrjen e masave për parandalimin e dhunës.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 2 (i preferuar): – Ndryshimi i ligjit ekzistues. Ndryshimi i ligjit ekzistues është opsioni i preferuar në këtë rast, duke qenë se nëpërmjet projektligjit që kërkohet të miratohet, synohen të trajtohen vetëm tri çështje, siç është karta e tifozit, përjashtimi nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar për Agjencinë e Shërbimit të Sportit. Ky konkluzion është arritur edhe pas takimeve të shumta që grupi i punës, ngritur me urdhrin e kryeministrit, nr. 57 datë 25.03.2019, ka zhvilluar, me qëllim identifikimin e problematikave të kuadrit ligjor në fuqi. Në përfundim, është konkluduar nevoja e ndryshimit të kuadrit ligjor në fuqi, ku konkretisht është propozuar trajtimi i pikave të sipërcituara.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Njësitë që do të jenë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur janë:

- Ministria përgjegjëse për sportin;
- Organizatat sportive, etj.

Pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të preferuar janë:

- Buxheti i limituar.
- Mospërbushja e detyrimeve të organizatave sportive ndaj tifozëve dhe anasjelltas.

Masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës janë:

- Mbrojtja e të drejtave të tifozëve dhe organizatave sportive nëpërmjet marrjes së masave të sigurisë në ambientet sportive, masa të cilat duhet të merren nga kompanitë private të sigurisë fizike, të cilat janë të specializuara dhe të trajnuara për të ofruar këtë lloj shërbimi.
- Monitorimi dhe parandalimi i dhunës së shfaqur gjatë aktiviteteve sportive, si dhe identifikimi i autorëve të veprave penale dhe vënia e tyre para përgjegjësisë ligjore.
- Qasje e integruar për rendin, sigurinë dhe shërbimet në ndeshjet e futbollit dhe aktivitetet e tjera sportive.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmblendhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre*

Monitorimi do të jetë një aktivitet i vazhdueshëm, i cili do të përfshijë mbledhjen e të dhënave dhe informacionin e kërkuar për matjen e indikatorëve të përcaktuar. Gjithashtu, ai do të jetë një instrument që do të përdoret për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara po zbatohen në praktikë sipas specifikimeve përkatëse dhe në të njëjtën kohë do të mbledhë informacionin e nevojshëm mbi arritjet dhe problematikat që mund të dalin gjatë zbatimit të këtij ligji.

Ministria përgjegjëse për sportin do të ketë rolin kryesor në monitorimin, koordinimin dhe menaxhimin e zbatueshmërisë së këtij projektligji. Për aktivitete në të cilat ministria përgjegjëse për sportin do të jetë partner kryesor, monitorimi do të kryhet direkt nga strukturat përkatëse të saj. Për aktivitetet në të cilat kjo ministri është partnere mbështetëse, monitorimi do të bëhet në mënyrë indirekte përmes vizitave në terren, mbledhjes së të dhënave nga partnerët dhe raportimeve përkatëse. Ministrinë e linjës si dhe institucionet e tjera (shtetërore apo të huaja), janë përgjegjëse për arritjen e objektivave përkatëse të parashikuara.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

në milionë lekë

	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Shënim: Kosto “Kosto për grupet e tjera – në vazhdim”, janë kosto për investime që parashikohet të mbulohen nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, për një periudhë 10 vjeçare.

Përfitime “Përfitimi për biznesin – në vazhdim”, janë parashikuar të ardhura që mund të realizohen nga biznesi, nga shitja e biletave për aktivitete rinore apo sportive, qiradhënie, shërbime nga bizneset, aktivitete të tjera.

“Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim”, janë parashikuar të ardhura që mund të realizohen nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, njësi shërbimesh të krijuara prej tyre që administrojnë mjedise për Rininë, nga shitja e biletave për aktivitete rinore apo sportive, qiradhënie, shërbime nga bizneset, aktivitete të tjera.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1_Financimi me fonde nga Buxheti i Shtetit			
Opsioni 2			

Opsioni 1 _

Opsioni i 2_